

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-26-1322-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA – Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve-Lot I-II**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	TRIUMF SH.P.K.
NUI	811291400
Adresa	Rruga Edit Durham pn
Vendi	Prizren
Kodi postar	20000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Xhemile Tershani
Adresa elektronike	shpktriumf@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	30.04.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA-Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve-Lot I|81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA-Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve-Lot II

Njoftimi për kontrate

Kerkesa Per Rishqyrtim 24.04.2026

Vendimi AK 29.04.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

PO kemi dorezuar konform ligjeve në fuqi

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 27/A Ndarja e kontratave në Lote

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me qenë se AK nuk ka shqyrtuar pretendimet tona nw kerkese per RI-shqyrtim ne po e ridergojm te njejtat pretendime ne OSHP pasi qe shaku i nje gabimit teknik mos vendosja e neneve te shkeluar AK ka tentuat ti ik pergjegjesis.

NE kur kemi kerkuar sqarime pse jane te vendosura ato specifikime dhe kerkesa ne te njejten kohe edhe kemi kerkuar largimin e tyre edhe mundesin e zgjerimit te konkureses.

Ju lutemi të na sqaroni lidhur me specifikimet teknike të pajisjeve të kërkuara në këtë procedurë të prokurimit, të cilat përfshijnë kufizime të sakta për peshë, madhësi dhe fuqi (kW). Sipas vlerësimit tonë, këto kërkesa janë jashtëzakonisht specifike dhe nuk kanë qenë të kërkuara në procedurat e mëparshme të tenderëve për shërbime të pastrimit. Në procedurat e mëhershme nuk janë kërkuar pajisje të tilla si: traktorë me kapacitete të caktuara, kamioneta, furgonë elektrikë apo fshesa rrugore me peshë të caktuar në kilogramë. Për këtë arsye kërkojmë sqarim: Për çfarë arsye janë kërkuar këto pajisje me specifikime kaq të detajuara teknike? Pse është kërkuar që fshesa rrugore të ketë peshë specifike (p.sh. 1800 kg), ndërsa nuk lejohen variante të tjera si 1900 kg apo 2100 kg? Pse është përcaktuar fuqia prej vetëm 11 kW për fshesën dhe nuk janë pranuar variante me

fuqi më të madhe (p.sh. 20 kW apo 30 kW)? Për Lotin 2, pse është kërkuar traktor me fuqi 50 kW pa u specifikuar kufi minimal apo maksimal dhe a lejohen alternativa me fuqi 25 kW, 35 kW, 60 kW apo 100 kW? Pse janë përcaktuar dimensione kaq specifike për traktorin (p.sh. minimum 900 mm –maksimum 1000 mm dhe minimum 1000 mm – maksimum 1150 mm)? Për çfarë arsye është kërkuar që traktori të ketë kabinë dhe lopatë, dhe a është kjo një kërkesë funksionale apo një preferencë specifike? Pse është kërkuar furgon elektrik me fuqi 40 kW, kur për kryerjen e shërbimeve të njëjta mund të përdoren edhe furgonë me naftë apo benzinë? Për çfarë arsye janë kërkuar gjithashtu tre pick-up apo furgonë shtesë 3 furgon apo pikap pse esht kerkuar elektriku kur jan 3 pikap me naft apo dizell apo benzin pse te jet elektrik na spejego me qfar arsye jet ky lloj furgoni ? Duke marrë parasysh që këto kërkesa nuk janë përdorur në procedurat e mëparshme të prokurimit për shërbime të pastrimit, ekziston shqetësimi se specifikimet mund të jenë tepër kufizuese dhe potencialisht diskriminuese për operatorët ekonomikë dhe ketu shihet qart qe ka shum kritere diskriminuse dhe favorizuse per oe te preferuar te juaj te cilet shihen kjart qe kan keto lloj paisje. Prandaj, kërkojmë nga autoriteti kontraktues të japë sqarime të detajuara lidhur me arsyetimin teknik dhe funksional të këtyre kërkesave.

Panel i nderum kerkojm trajtimin e duhur te kesaj ankese pasi qe ka plote kritere diskriminuese dhe favorizuese te cilat brenda afatit te parapre me ligj do i poltesojm. Kerkesa jone eshte e qarte Sqarimi i kritereve, largimi i tyre duke na dha mundesi me marrur pjes pasi qe jemi kompani me renome kombetare.

SIPAS AFATVE LIGJORE DO PLOTESOJM ANKESEN

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

mos dhanja e mundesis me marr pjese

mundesia e fitimit te kontrates

ndjenja e diskriminimit dhe trajtimit te barbart

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*